



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.209/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët : Bujar Muzaqi kryesues, Skender Çoçaj, dhe Kymete Kicaj, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Komuna Prishtinë parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të vendosjes së materialit zgjedhor-posterit në hapësirat publike, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen me datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me 28.01.2025, mori këtë :

V E N D I M

HEDHET E PALEJUAR ANKESA e parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) A.nr.209/2025 datë 26.01.2025, parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Komuna Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datën 26.01.2025, PZAP-i, ka pranuar ankesë A.nr.209/2025, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje, parashtruar kundër subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën pretendon se më 26 janar 2025, aktivistet të Lëvizjes Vetëvendosje (LVV), kanë identifikuar se baneret/posteret e kandidatëve të shumtë për deputet të LDK-së, janë ende të vendosur në hapësirat e njëjta publike/rrugët. Më tutje në ankesë theksohet se edhe përkundër Vendimit të PZAP-i me numër Anr.85/2025 të datës 24 janar 2025, në të cilën ka përfshirë dhe trajtuar ankesat me numër Anr.85/2025, Anr.86/2025, Anr.88/2025, Anr.106/2025, Anr.107/2025, Anr.108/2025, Anr.109/2025, Anr.115/2025, Anr.116/2025, Anr.117/2025, dhe Anr.118/2025, të kandidatëve për deputetë nga radhët e subjektit Politik LDK-së si: Lumir Abdixhiku, Izet Sadiku, Fiknete Bejta, Shkemb Manaj, Sokol Havolli, Doruntinë Maloku, Besian Mustafa, Doarsa Kica Xhelili, Arben Gashi, Alban Zogaj Sibel Halimi dhe kandidatë të tjerë posterët e të cilëve janë të vendosur në hapësirat e ndryshme publike si Rrugët : “Rruga C”, “Hemine Lekaj”, “Afrim Zhitia”, “Xheladin Rekaliu”, “Enver Maloku”, “Fehmi Ladrovci”, “Arbënor e Astrit Dehari”, “Eqrem Çabej” e të tjera, me të cilin për veprimet e njëjta subjektit Politik (LDK) është sanksionuara në kundërshtim me dispozitat e nenit 34, paragrafi 1 nën paragrafi 1.2, të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme ne

Republikën e Kosovës –LZP. Po ashtu në ankesë pretendohet se postert/baneret e tillë ende janë të vendosura në këto hapësira përkatëse publike në kundërshtim me dispozitat e LZP-së, Si provë ka bashkangjitur fotografi të printuar lidhur me rastin në fjalë që dëshmon vendosjen e banerit/posterit në fjalë në kundërshtim me LPZ si dhe foto dhe link i Vendimit të PZAP Anr.85/2025.

Kërkojmë nga PZAP-i që në rast se gjejmë shkelje në këto veprime, të shqiptoj sanksionin e merituar sipas legjislacionit në fuqi.

Në përgjigje në ankesë subjekti politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) thekson se pretendimi se subjekti politik LDK nuk ka respektuar Vendimin A.nr.85/2025, nuk qëndron sepse të njëjtin e ka ankimuar në Gjykatën Supreme të Kosovës brenda afatit të paraparë prej 48 orësh, në përputhje me nenin 118.4 të LZP-së dhe kështu Vendimi i PZAP nuk ka marrë formë të prerë, që nënkupton se ende nuk është i përmbarueshëm apo ekzekutueshëm përderisa Gjykata Supreme të vendos sipas ankesës së bërë nga subjekti LDK.

Përgjigjes ia ka bashkangjitur urdhërpagesën e lëndës së dorëzuar në Gjykatën Supreme të datës 28.01. 2025.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës gjeti se :

-Ankesa është e palejuar.

Paneli pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se ankesa e parashtruar nga subjekti politik LVV, ka njëjtësi objektive, gjendje të njëjtë faktike me ankesën Anr.85/2025 të parashtruar me datë 21.01.2025 nga po i njëjti subjekt politik LVV, kundër të njëjtit subjekt politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Komuna Prishtinë, përkatësisht kandidatëve për deputet Lumir Abdixhiku, Izet Sadiku, Fiknete Bejta, Shkëmb Manaj, Sokol Havolli, Doruntinë Maloku, Besian Mustafa, Doarsa Kica Xhelili, Arben Gashi, Alban Zogaj, Sibel Halimi dhe kandidatë të tjerë posterët e të cilëve janë të vendosur në hapësirat e ndryshme publike si Rrugët : “Rruga C”, “Hemine Lekaj”, “Afrim Zhitia”, “Xheladin Rekalii”, “Enver Maloku”, “Fehmi Ladrovci”, “Arbënor e Astrit Dehari”, “Eqrem Çabej”, e cila çështje është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.85/2025 të datës 24.01.2025, Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK) me seli në Prishtinë i është shqiptuar dënimi me gjobë në lartësi prej 12,000.00 (dymbëdhjetëmijë) Euro.

Meqenëse për rastin në fjalë është vendosur me vendimin e PZAP-it, Anr.85/2025 të datës 24.01.2025, dhe pasi që për të njëjtën çështje është vendosur në vendimin e lartcekur paneli nuk u lëshua fare në shqyrtim të çështjeve të theksuara në ankesë, pasi që ne baze të nenit 101 të LPA-se “*Kërkesa e përsëritur 1.1 nën paragrafi 1.2 Një organ publik përfundon një procedurë administrative, në cilëndo fazë të saj, nëse zbulon se: një procedurë administrative tjetër, nisur sipas një kërkesë tjetër të paraqitur nga e njëjta palë me të njëjtin qëllim dhe bazuar mbi të njëjtën situatë faktike, është ende në proces shqyrtimi dhe e papërfunduar*”. Andaj, duke marr parasysh se në bazë të shkresave të lëndës dëshmohet se proceduara e zhvilluar për lëndën Anr.85/25, e cila është e njëjte me këtë rast, ende është në pritje të shqyrtimi për ankesë në Gjykatën Supreme të Kosovës, Paneli ka vendosur se ankesa e ankuesi është e palejueshme.

Prandaj, nisur nga të gjitha arsyet e paraqitura lart, në pajtim me nenin 115.1 dhe 118.1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, lidhur me nenin 13 paragrafi 3 të Rregullores së PZAP-it Nr.01/2024 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi, duke e hedhur poshtë ankesën si të pa lejuar.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

Anr. 209/2025 datë 29.01.2025

**Kryesuesi i Panelit,
Bujar Muzaqi**



KËSHILLA JURDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LJP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.